

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
UJËSJELLËS KANALIZIMEVE, TIRANË PËR PROJEKTIN “MENAXHIMI I
MBETJEVE TË NGURTA**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ujësjellës Kanalizimeve, Tiranë, për projektin “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta”, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën nga fillimi i projektit deri 30.09.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 27 datë 31.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 857/10 datë 31.03.2014, dërguar Z. Adrian Alushaj, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, DPUK, Bashkia Tiranë dhe PIU, të marrin masa për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e përbashkëta, për realizimin me sukses dhe në kohë të projekteve të financuara nga donator të ndryshëm.

Menjëherë

2. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, DPUK, Bashkia Tiranë dhe PIU, të marrin masa që në të ardhmen, për projektet e përbashkëta të bëjnë koordinimin dhe bashkërendimin sa më të mirë të veprimeve, me qëllim realizimin dhe përfundimin e tyre (projekteve) brenda afateve të përcaktuara.

Menjëherë

3. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, DPUK dhe PIU të marrin masa për përdorimin e pjesës së mbetur të huasë së butë me ekonomicitet, efikasitet dhe eficientë.

Menjëherë

4. Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve, me përfundimin e projektit të marrin masa për dorëzimin e plotë të dokumentacionit përfituesit të programit, Bashkia e Tiranës, si dhe për pjesën tjetër të dokumentacionit të marrë masa për arkivimin në përputhje me ligjin “Për arkivat”.

Menjëherë

5. Nga Njësia e Zbatimit të Projektit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të marrin masa për të bërë efektive shtesën e kontratës së kompanisë [REDAKTUAR] për arsye se shtesa e kësaj kontrate është miratuar nga palët.

Menjëherë

6. Drejtoria e Menaxhimit të Venddepozitimit të Sharrës pranë Bashkisë së Tiranës, të marrë masa për vënien në funksionim të impiantit të përpunimit të biogazit, në mënyrë që djegia e

biogazit të mos bëhet artificiale, mënyrë e cila nuk garanton djegien e vazhdueshme dhe me parametra të kënaqshëm mjedisor.

Menjëherë

7. Drejtoria e Menaxhimit të Venddepozitimit të Sharrës pranë Bashkisë së Tiranës, të marrë masa për vënien në funksionim të mekanizmit tip “BOMAG BC 572 RB-2”, në mënyrë që të shmanget amortizimi i mëtejshëm i mjetit, si dhe dalja e mundshme jashtë përdorimi.

Menjëherë

8. Drejtoria e Menaxhimit të Venddepozitimit të Sharrës pranë Bashkisë së Tiranës, të marrë masa për vënien në funksionim të sistemit kompjuterik, në mënyrë që menaxhimi i sistemit të mbledhjes së mbetjeve, drejtimi i vend grumbullimit, peshimi, mbajtja e dokumentacionit, etj, të kryhen sipas parametrave të përcaktuara në program.

Menjëherë

9. Drejtoria e Menaxhimit të Venddepozitimit të Sharrës pranë Bashkisë së Tiranës, të marrë masa për hartimin e rregulloreve mjedisore të miratuara nga Ministria e Mjedisit, në mënyrë që gjithë procesi i punës në venddepozitim dhe trajtimi i mbetjeve, të garantojë parametra të kënaqshëm mjedisor duke përmbushur objektivat e përcaktuara në program.

Menjëherë

10. Drejtoria e Menaxhimit të Venddepozitimit të Sharrës pranë Bashkisë së Tiranës, të marrë masa për trajnimin e punonjësve të rinj, për trajtimin e përdorimin e pajisjeve të përfituara nga programi, në mënyrë që vënia në punë e tyre të jetë sa më efektive dhe të përmbush qëllimin e programit.

Menjëherë

11. Drejtoria e Menaxhimit të Venddepozitimit të Sharrës pranë Bashkisë së Tiranës, të marrë masa për menaxhimin e venddepozitimit sipas kërkesave të përcaktuara në program, në mënyrë që gjithë procesi i punës në venddepozitim dhe trajtimi i mbetjeve të garantojë parametra të kënaqshëm ekonomik e mjedisor.

Menjëherë

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve në bashkëpunim me Avokatin e Shtetit, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjyqimit, arkëtimin e shumës **374,059.9 Euro**, përfituar padrejtësisht nga subjekti ■■■. ■■■ si më poshtë:

- 31,325 Euro, për pagesë të pa justifikuar duke ndryshuar çmimin e kontratës për ndërtimin e zyrave të administratës. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 33.5 c, të kushteve të përgjithshme të kontratës.

- 15,771.1 Euro, për punime të likuiduara, por të pa realizuara në zbatimin e rrethimit perimetral në venddepozitimim e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.
- 163,008 Euro, për punime të likuiduara dhe të porealizuara në sasinë e përcaktuar në kontratë, për ndërtimin e mureve mbajtëse të zonës së shërbimit dhe rrugëve në venddepozitimim e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.
- 85,783.7 Euro, për punime të likuiduara por të porealizuara në shtrimin e sipërfaqes së zonës së shërbimit dhe rrugëve në venddepozitimim e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.
- 78,172.11 Euro, për punime të likuiduara por të porealizuara në lidhje me kanalizimet e parashikuara të ndërtoheshin me shtresë betoni, për drenazhimin e ujërave sipërfaqësore në venddepozitimim e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në Nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe të pikës 4 të nenit 11 të Kontratës Individuale të Punës, kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim me paralajmërim për pushim nga puna”

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë Koordinator i projektit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, Tiranë”, për arsye se:

-Në dokumentet e financës nuk ka bashkëlidhur kërkesat dhe faturat e kompanisë [REDAKTUAR] për kryerjen e pagesës;

-Nuk ka kërkuar nga kompania [REDAKTUAR] një relacion ku të përcaktohet produkti që ka sjellë konsulentit dhe që korrespondon me kërkesën dhe faturën si dhe mungon dokumentacioni justifikues që shoqëron pagesat. Dokumentacioni justifikues për pagesat e konsulentit, është konsideruar vetëm situacionet i certifikuar për kontratën e punimeve.

-Në dokumentacionin e PIU, mungojnë dokumentet shoqëruese të hyrjes së mallit, si fatura e shitësit, origjina e mallit, garancia e prodhuesit/shitësit, librezat e mjetit, akti për gjendjen teknike të makinerive, libri i përdorimit, fleta e zhdoganimit për makineritë e reja, specifikimet teknike të makinerive, garancia e kompanisë së kontraktuar, etj., mungon urdhri për kalimin e mjeteve përfituesit përfundimtar të projektit, Bashkisë Tiranë/ Ndërmarrjes së Përpunimit të Plehut, për arsye se kalimi i vlerave monetare dhe materiale, nuk bëhet me urdhër të komisionit të kolaudimit, por me urdhër të titullarit i cili ka nënshkruar kontratën për sigurimin e pajisjeve, mungon procesverbali apo akti për dorëzimin e mjeteve dhe marrje në dorëzim nga strukturat e Bashkisë Tiranë.

D. Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson së tepërmi kontributin e vyer të Qeverisë Italiane në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane. Në të njëjtën kohë, informojmë se, gjatë auditimit të Projektit “Menaxhimi i mbetjeve urbane të Tiranës”, ka rezultuar se në zbatimin e kontratës së punimeve

civile (Kontratë e përzier), Konsulenti █████ SpA, ka certifikuar dhe likuiduar punime të pakryera Kontraktorit █████ SpA, duke shkaktuar një dëm ekonomik në shumën 374,060 Euro, si më poshtë:

- 31,325 Euro, për pagesë të pa justifikuar duke ndryshuar çmimin e kontratës për ndërtimin e zyrave të administratës. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 33.5 c, të kushteve të përgjithshme të kontratës.

- 15,771.1 Euro, për punime të likuiduara, por të pa realizuara në zbatimin e rrethimit perimetral në venddepozitimin e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.

- 163,008 Euro, për punime të likuiduara dhe të parealizuara në sasinë e përcaktuar në kontratë, për ndërtimin e mureve mbajtëse të zonës së shërbimit dhe rrugëve në venddepozitimin e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.

- 85,783.7 Euro, për punime të likuiduara por të parealizuara në shtrimin e sipërfaqes së zonës së shërbimit dhe rrugëve në venddepozitimin e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.

- 78,172.11 Euro, për punime të likuiduara por të parealizuara në lidhje me kanalizimet e parashikuara të ndërtoheshin me shtresë betoni, për drenazhimin e ujërave sipërfaqësore në venddepozitimin e Sharrës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Neni 37, Pika 1, dhe Neni 38, Pika 2.

Për shkeljet e konstatuara më sipër, do të informohet Ambasada Italiane në Tiranë.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Yllka Pulashi, Mimoza Bedini, Mimoza Lloji, Artan Topjana, Jorida Zhegu, më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHITETIT